

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjaku blu i magjistratëve dhe çirakët e Republikës
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/08/gjaku-blu-i-magjistrateve-dhe-ciraket-e-republikes/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:36:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 13:39:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	07a7135aec18d536931a0d66f32ca292147e4bdf9e72cb598a67dbe5dbc8106
TEKSTI	f2cd3c873445207a4b0ad426f479252381ec72678dd7cd1762f3e056eec08381
PAMJA	428638e36ea566bd8335f7ca5441d749bd1d74125a347adb486fffd03cf6d611

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bd79fe24ae1cdcdd2e6cab288084e4368843ab41b9d35c68a5544592e04fa1ee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bd79fe24ae1cdcdd2e6cab288084e4368843ab41b9d35c68a5544592e04fa1ee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjaku blu i magistratëve dhe çirakët e Republikës

Analizë

Publikuar: 08/09/2026



Nga Ylli Manjani

Pagat e magistratëve nuk janë më një debat për pavarësinë e drejtësisë. Ato janë tashmë një debat për diskriminimin social që po prodhon vetë shteti.

Një shef komisariati paguhet rreth 90 mijë lekë në muaj. Një prokuror apo gjyqtar, me sistemin që ia ka vendosur vetes, paguhet 900 mijë lekë në muaj e më shumë.

Dhjetëfish diferencë!

Absurd i ulur këmbëkryq!

Shefi i komisariatit është në gatishmëri njëzet e katër orë, shtatë ditë në javë. Nuk e pyet askush nëse është e diel, natë apo festë. Ai del në aksidente, vrasje, protesta, konflikte, operacione policore. Rreziku është pjesë e përditshmërisë së tij. Një vendim i gabuar mund t'i kushtojë jetën.

Po prokurori?

E fillon punën në orën tetë. Në orën nëntë ka pirë kafën e parë. Në drekë është në restorant. Në gjyqe vjen zakonishtni papërgatitur. Në katër pasdite ka mbyllur zyrën. Natyrisht, puna e tij ka përgjegjësi të mëdha juridike, por rreziku fizik krahasuar me policin është pothuajse zero.

Megjithatë, ai paguhet dhjetë herë më shumë.

Kjo nuk është më diferencë page. Kjo është shpallje kastash.


Me të lexuarat



Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e Ramës, Besnik Leskaj... dha tender Besnik Leskaj



Besnik Leskaj pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në merrshmi i administratës



Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik Roka dhe Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit



Enri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Ironia është edhe më e madhe, kur mendon se pa punën e policit nuk ekziston dosja e prokurorit. Është polici që mbledh provat, ndjek autorët, arreston, ekspozohet në terren. Prokurori ndërton akuzën mbi punën e policisë. Por në fund polici mbetet çiraku, ndërsa prokurori bëhet mbreti.

Kur diferenca bëhet dhjetëfish, nuk ndryshon vetëm paga, as vetëm hierakia. Ndryshon edhe ngjyra e gjakut. Polici ka gjak të kuq. Magistrati ka fituar gjak blu.

Po mësuesi?

Mësuesi, që edukon brezat, merr rreth 75 mijë lekë në muaj. Gjykatësi merr të paktën 900 mijë. Mbi dhjetë herë më shumë.

Me një vendim pagash, Republika e KLGJ-së ka shpallur se ai që dënon njeriun vlen dhjetë herë më shumë se ai që edukon njeriun.

Pastaj habitemi pse zbrazen shkollat dhe mbushen burgjet.

Shoqëria paguan më shumë xhelatin sesa edukuesin.

Ky është mesazhi që japin edhe këto paga.

Të kuptohemi, pagat e mirë janë garanci e pavarësisë së drejtësisë. Askush nuk e mohon që gjyqtari dhe prokurori duhet të paguhet mirë. Por pavarësia nuk është privilegj. Nuk është titull fisnikërie. Nuk është licencë për të ndërtuar një aristokraci financiare brenda administratës publike. Nuk është dekret dallimi social.

Pavarësi do të thotë të jesh i lirë nga ndikimi politik, por nuk do të thotë të jesh i pavarur nga shteti që të paguan.

Sot magistratët praktikisht i kanë thënë Republikës: ne jemi shtresa më e lartë e saj. Mbi policin. Mbi mësuesin. Mbi mjekun. Mbi ushtarakun. Madje edhe mbi deputetin. Mbi kryetarin e shtetit po e po, po Ai se ke mendjen këtu...

Deputeti, që voton ligjet që gjyqtari dhe prokurori janë të detyruar t'i zbatojnë, paguhet rreth 300 mijë lekë në muaj. Gati trefish më pak.

Pra, jo vetëm mbi administratën. Magistratët kanë ngritur veten edhe mbi pushtetin ligjvënës.

Kjo nuk është ndarje pushtetesh. Kjo është hierarki shoqërore e vetëshpallur.

Dhe këtu fillon problemi kushtetues e politik.

Pagat nuk mund të ndërtohen sipas logjikës së kastave. Nuk mund të jetë secili pushtet që i cakton vetes vendin në majë të piramidës. Përndryshe, nesër çdo institucion do të shpallë veten

më të rëndësishmin e Republikës.

Parlamenti ka detyrimin të rivendosë logjikën e shtetit. Të ndërtojë një sistem të integruar pagash, ku përgjegjësia, ngarkesa, rreziku dhe rëndësia publike të peshohen me të njëjtën masë për të gjithë. Jo një sistem ku secili pushtet i vendos vetes kurorën dhe pastaj i kërkon qytetarëve ta quajnë këtë “pavarësi”.

Sepse nuk ka pavarësi nga shteti.

Ka vetëm pavarësi brenda shtetit.

Dhe në një republikë, gjaku i askujt nuk mund të jetë blu.

TAG:

Gjaku blu

magjistratët

Të ngjashme



Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor



John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?



Demokracia jonë pa hardware dhe software?!

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION **DOSJE ROZË**
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)